

Dr. Zejnepe Alili - Rexhepi

## PORTRETIZIME VLERASH POETIKE “MES LULEVE DHE LOTIT”

(Vëllimi poetik “Mes luleve dhe lotit” - Besim Xhelili)

Të hidhje një vështrim analitik në brendinë e vargjeve të librit “Mes luleve dhe lotit”, sigurisht do të ndiheshe me fat, nëse autorin e këtij libri, e njihje për së afërmi, meqë filozofia vetjake e një artisti, gjithmonë është ai shtegu që e kahëzon ngritjen e tij në art.

Në një pasdite të rënduar pune, nga ato të lodhshmet në pritje të fundjavës, kur vetëm librin mund ta përzgjidhje për shoqëri, si një mik të besueshëm për t'i pëshpëritur sekretet, dilemat, raportin me vetë librin dhe jetën..., më kujtohet që, në zyrën time, në universitet, ku nëpër sirtarë mbaja shumë libra, kryesisht të dhuruar nga miqtë e mi, më zuri dora librin e Besim Xhelilit, mikut dhe bashkëvendësit tim, poetit tetovar që prej vitesh jetonte në Vjenë (Austri). Asnjë rastësi në përzgjedhje...! Thjesht, shumë këndshëm më tërhoqi titulli i librit “Mes luleve dhe lotit”, pasi më kujtoi thënien e një poeti: “Ti, lulet nuk i shkel! As unë nuk mundem dot t’u marr erë”!

Megjithëse, librin e kisha lexuar qysh në korrik (kur edhe pata fatin ta merrja nga vetë autori, me autograf të tij), sepse rrallë ndodh që ta zvarris leximin e librave poetikë, me pretekstin se do ta lexoj një rast, kur të kem më shumë kohë. Zakonisht, i lexoj me ëndje dhe sapo më dhurohen, mirëpo ishte e vështirë që këtë libër, ashtu vetëm si të lexuar ta vendosje në sirtar..., gjithsesi poezitë në të, të joshnin për më shumë vëmendje! Veçmas, kur kupton se vargu poetik është më shumë se frymëmarrje, është vetë pëshpërima, e qeshura, drithërima, pikëllimi..., është veta pulsi i jetës! Nganjëherë, vargu është vetë trazimi i shpirtit që çohet peshë nga fuqia e fjalës!

“Mes luleve dhe lotit”, ky titull i brishtë, por ngacmues dhe përdëllimtar, që konceptuar në tri cikle poetike: “...ethe Atdheu”, “Mes luleve dhe lotit” dhe

“Përmallim”. Rreth 70 poezi vargëzohen këtu, me një ndarje jo të barabartë, ku mbizotëron cikli i parë “...ethe Atdheu”. Me të drejtë mbase, festa njëshekullore e Pavarësisë së Shqipërisë, atdheut shpirtëror të të gjithë shqiptarëve, nuk kishte si të mos bëhej kumbim fjale e shpirti edhe për poetin Besim Xhelili!

Mbarështrimi poetik i nocionit Atdhe ka nismën tek ai zjarri i përhershëm, që të shtyn të pagëzosh poezitë: “Shqipëria ime”, “Atdheu im i dashur”, “Abetarja”, “Iliria”, “Atdhe e mëmëdhe”, “Larg Atdheut”, ... dhe të gjitha këto përmbajnë ndjenjën e trazuar kur tejkalohen 100 vite sfidash, për 100 vite dritë e fjalë të lirë! Të hapësh portat e Atdheut dhe të mos e ndiesh mallin që të pushton për të, është e pamundur. Po a nuk është atdheu, dashuria e të gjitha dashurive?! Hajdegeri, në esenë: “Qenia dhe koha” jep shpjegimin e të mbijetuarit në kohë dhe në realitet edhe ne, vetëm me identitetin që marrim nga atdheu, herë të copëzuar e të paemër, herë krenar e madhështor, i mbijetojmë kohës.

Dy shtrirjet e rëndësishme të perceptimit poetik, ato: individuale dhe historike, në një farë mase e ruajnë ekuilibrin e mendimit vetjak të autorit! Gjurmët e kombëtares, thuhet janë të dyzuara. Janë parabola që i lidhin temat: vendlindje - dashuri - atdhe.

Përshkruar në një tis anatemizmi vargëzohen fjalët dhe mendimet e poetit. Në poezitë “Katilët” (28) dhe “Qentë e tërbuar” (34), zë vend simbolika e trajtimit të së keqes, përmes figurave, si: përbindëshat, ujqit, buburrecat, katilët, ardhacakët, por sigurisht kjo ndjesi, tek ky poet (nuk vjen si fobi e errësirës, ambienteve të mbyllura, së keqes e trishtimit, sikurse tek poezia e E. A. Po-së), por vë në spikamë vetë ngjarjet dhe ambientet, ku prej kohësh ka bërë vend e keqja e të huajve, pushtuesve, “ardhacakëve”, siç i quan poeti. Me këtë, mjeshtërisht ngrihet “Teatri i kafshëve të egra” (22), ku në formën më të plotë, natyrisht artistike, del në pah ligësia e pushtuesve. Kjo histori e dhimbshme shekullore, që e barti si barrë atdheu, shpesh arratis të vërtetën, andaj mjaft poezi të ciklit të parë i ruajnë këto kujtime, ndonëse të hidhura! Ato, përmes artit poetik mbeten reliktet e brezave që do vijjnë!

Në këtë vëllim, brendatrupëzohen tri nivele ligjërimi: përshkrues, krahasues dhe gjykues. I pari, reflekton ngjyrimin emocional të përjetimit dhe vetë ngjarjes, përderisa niveli i dytë vë në spikamë dy kohë, që lënë gjurmë në kapërcimet e njëra-tjetrës, dikur dhe sot..., kjo dhe bëhet linja përshkruese e poetit përballë kohës. Niveli i tretë vjen inferior ndaj botës, mohimit..., gjykim ky emocionalisht autentik dhe i hartuar bukur! Këtu edhe shënohet paralelja poetike e një ndjeshmërie artistike e njerëzore. Andaj, poeti përmes poezive: "I dehur" (62), "Digjem" (58) dhe "Ndodh (57), duke përdorur logjikshëm pyetjen retorike, sikur paralajmëron përmes vargjeve: "Kur librat në rafte i mbulon pluhuri / Njerëzimit i mbyllet dyert para ardhmërisë", (Kur 32).

Kjo, kryekëput ishte edhe porosia e shumë Rilindësve, megjithëse poetit i shërben si model frymëzimi vargu Naimian e veçmas Asdreni me porosinë e Zotit... "Se Zoti vetë e tha me gojë, Shqipëria do të rrojë" (13). Mes tjerash, apostrofa e përdorur dendur të rikujton vargjet e Naimit, poashtu edhe personifikimi, i cili sajohet me një intonacion karakteristik tingëllimor. Dialogu me erën, tek "Merrmë ti erë (71), pastaj edhe shiu e zogjtë, veçmas dallëndyshet..., një personifikim i gjetur për të mbajtur lidhjen e fortë të dashurisë dhe mallit për atdhe. Në poezinë e Xhelilit, gjithashtu ka shumë alegori, megjithëse ajo mbetet në sfond të poezisë, duke u lënë vendveprim figurave të tjera, të cilat përbëjnë një kurorë të tërë figuracioni.

Me një dendësi dhe korrektësi tematike, në të vërtetë, krijohet një simfoni ambiguitetesh, meqë shpesh metaforat bashkëveprojnë, me të njëjtin intensitet. Për këtë arsye, mendoj se vëllimi ka më shumë mundësi interpretimi, si temë me një shtrirje të gjerë, në dukje.

I ndikuar nga motivi i atdhedashurisë, me simbolikën e mallit për vendin e tij, vendlindjen, nënën, pragun e shtëpisë..., edhe ky poet merr vulën e identifikimit në botën letrare. Poezitë e këtij diskursi, siç janë: "Unë nga larg" (44), "Dallëndyshet e mia" (72), "Përshefca ime" (74), "Mall" (76), dëshmojnë përpjekjet për të ruajtur dinjitetin dhe identitetin kombëtar, poezi që s'janë

vetëm ndjesi rrëfenjash, por edhe “vetëtima simbolike”, të ngritura mbi një botë të begatshme shpirtërore.

Në këto poezi, vendlindja vendoset në frymë lirike të ndryshme: “herë si mall i pashuar mërgimtarësh a gur ëndërrimtar i të riut në kurbet; herë dhembje e gjakim i atyre shqiptarëve që e braktisën vendlindjen, madje edhe si shfrymë ndaj atyre që e përbuzën. Pra, herë Diogjen e herë Don Kishot, poeti mbetet përpara sfidave të vendlindjes dhe vargun poetik e sajon përmes fjalësh të pakta, por të zgjedhura, me një forcë të lartë ndërtuese”.

Duke poseduar ndërgjegjen estetike, poeti i hap rrugë frymëzimit të tij dhe i strukturon në kohë poezitë, pra edhe poezitë erotike. Kjo ndjenjë është shprehur në mënyrë më diskrete, përmes monologut të brendshëm.

Për atë që poeti kishte parasysh të shenjzonte, më erdhi e dobishme cytja që të ndeshem me një kontakt shpirtëror, gjë që do të linte gjurmë, padyshim edhe në këndvështrimin e analizës sime. Ajo që veçmas të bën përshtypje në veprën e B. Xhelilit është komunikimi me fëmijërinë, rininë, faza jetësore të paharrueshme. Edhe poezitë: “Mësuesi im” (77), “Erdhi shtatori” (78), “Malli im (79), Nëna (80), “Mall nëne” (81), na shpiejnë në kohë të largët, në vendbanimin e fëmijërisë së poetit, ku kujtimet e tij djaloshare ngrihen në flatra ëndrrash. Poashtu, rikujton disa nga shokët e fëmijërisë, të cilët fati nuk i përkundi me ninullat e jetës..., asaj jete që nganjëherë për dikend tregohet e kursyer në përkëdhelje e ëndrra.

Gjithsesi, vëmendje të posaçme u kushtoi kujtimeve më të bukura të jetës - fëmijërisë, po ashtu dhe rinisë, ku përpos imazheve magjepsëse të natyrës së vendlindjes, kujtime të cilat i palosi sipas notave mbresëlënëse në memoaret e tij. Mbizotorojnë përjetimet e dashurisë së parë, përpjekje këto sa të ëmbla e të trishta njëkohësisht, që e kanë si zberthim botën psikologjike e sociale. Me këtë rast, poeti ynë përpiqet të krijojë balansin e një trazimi ndjesor, përcjellur me mosdurim e drithërima “purteke” të moshës, ndonëse vetë ai mbetet protagonist

i këtij motivi. Janë të veçanta dhe të një kodi urban, vargjet: “Si e ka numrin / Zemra jote / Ta thërras / Kur ti fle...!? (53).

Vargjet vënë në spikamë një botë të bukur ndjesore, në raportin “Unë e ajo”, por këto krijime poetike shpesh nuk kanë dialog, as baraspeshë komunikimi, nuk shfaqin emocion të qëndrueshëm, e të paluhatshtëm..., por ato i dedikohen një strukture të botës paksa tradicionale, siç është vetë jeta në këtë vendbanim! Po ky shenjzim i botës së dy të rinjve, në harmoni me kornizimin e përgjithshëm me botën njerëzore, të rrethit shoqëror, nuk gjen realizim, por mbetet vetëm një mbretëri hyjnore e tyre, pa mundësinë e të shprehurit me një liri të mjaftueshme. Melankolia, ishte si nxitje, që poeti të vijë ndryshe nga poezia në poezi.

Të lexuarit dhe të ndjerit e vargjeve të B. Xhelilit, të bëjnë të kuptosh që ai nuk shkakton shkëndijëza malli në shpirtin e secilës vashë, por vetëm të asaj që e adhuron, pavarësisht që krijon një spektër imagjativ për vete, gjë që të bën që vargun e tij ta ndiesh edhe si një fije drite ndonjë buzëmbremje plot melankoli, edhe si një yll i vetmuar i një nate pa hënë, por edhe si fluiditeti i ditëve plot gjallëri e jetë.

Tërë ky emocion ka një shtrirje universale, me një mesazh të ndjerë si të domosdoshëm për kërkime të reja brenda poezive të vëllimit poetik “Mes luleve dhe lotit”. Besoj që ky libër, me forcën e vet të frymëzimit, ashtu siç bëri me grishjen e muzave, ka dhuntinë që të “grishë” edhe lexuesin e devotshëm e bashkë me të t’i sfidojë kohërat!